

LIGJI NR.08/L-275

PËR RRUGËT

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të Nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR RRUGËT

Neni 1 Qëllimi

1. Ky ligj ka për qëllim të rregulloj pozitën juridike, mënyrën e përdorimit të rrugëve publike të kategorizuara dhe të pakategorizuara, planifikimin, ndërtimin, financimin, kategorizimin, menaxhimin, mirëmbajtjen, mbikëqyrjen, masat për mbrojtjen e rrugëve, trafikut që zhvillohet në to dhe themelimin e Agjencisë së Rrugëve të Kosovës.

2. Ky ligj është pjesërisht në përputhje me:

2.1. Direktivën 2008/96/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 19 nëntor 2008 për Menaxhimin e Sigurisë së Infrastrukturës Rrugore e ndryshuar me Direktivën (BE) Nr.2019/1936 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 23 tetor 2019 për ndryshimin e Direktivës 2008/96/ KE për Menaxhimin e Sigurisë së Infrastrukturës Rrugore.;

2.2. Direktivën 2010/40/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 7 korrik 2010 mbi kornizën për vendosjen e sistemeve inteligjente të transportit në fushën e transportit rrugor dhe për ndërlidhjet me mënyrat e tjera të transportit, e ndryshuar me Vendimin (BE) 2017/2380 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 12 dhjetor 2017 që ndryshon Direktivën 2010/40/BE në lidhje me periudhën për miratimin e akteve të deleguara dhe me Direktivën (BE) 2023/2661 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 22 nëntor 2023;

2.3. Direktivën 96/53/KE e datës 25 korrik 1996 për përcaktimin e dimensioneve maksimale të lejuara në trafikun e brendshëm dhe ndërkombëtar si dhe masave maksimale të lejuara në trafikun e brendshëm dhe ndërkombëtar për automjete të caktuara rrugore që qarkullojnë në vendet e BE-së, e ndryshuar me Direktivën 2002/7/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 18 shkurt 2002, Direktivën (BE) 2015/719 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 29 prill 2015, Vendimin (BE) 2019/984 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 5 qershor 2019 dhe Rregulloren (BE) 2019/1242 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 qershor 2019;

2.4. Direktivën (BE) 2019/520 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 19 mars 2019 për ndërveprimin e sistemeve elektronike të tarifave rrugore dhe lehtësimin e shkëmbimit ndërkufitar të informacionit për mospagimin e tarifave rrugore në Union, e ndryshuar me Direktivën (BE) 2022/362 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 24 shkurt 2022;

2.5. Direktivën (BE) 2015/719 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 29 prill 2015 që ndryshon Direktivën e Këshillit 96/53/KE për përcaktimin e dimensioneve maksimale të lejuara në trafikun e brendshëm dhe ndërkombëtar si dhe masave maksimale të lejuara në trafikun e brendshëm dhe ndërkombëtar për automjete të caktuara rrugore që qarkullojnë në vendet e BE-së.

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e këtij ligji janë të detyrueshme për të gjitha institucionet qendrore dhe lokale, personat fizik dhe juridik si dhe për të gjithë subjektet të cilët merren me planifikimin, ndërtimin, financimin, kategorizimin, menaxhimin, mirëmbajtjen, mbikëqyrjen, masat për mbrojtjen e rrugëve si dhe përdoruesit e rrugëve publike.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:

1.1. **ASRr** - Auditimi i Sigurise Rrugore.

1.2. **Agjencia** - është Agjencia e Rrugëve të Kosovës (ARrK) ;

1.3. **Autoudhë** - rrugë publike e projektuar dhe ndërtuar posaçërisht për trafikun e mjeteve motorike e cila nuk i shërben pronave për rreth kufijëve të saj dhe e cila është e shënuar me shenjë të posaçme të trafikut, ka dy shirita rrugor të ndarë fizikisht për lëvizje me kahje të kundërta. Shiriti rrugor duhet t'i ketë së paku dy shirita të trafikut me nga një shirit për ndalje emergjente në të dy anët e autoudhës. Rrugët e nyjeve të autoudhës janë pjesë e autoudhës.

1.4. **Bankinë** - element i rrugës publike me mbushje e cila ofron siguri anësore, stabilitet të konstruksionit të rrugës dhe shërben për vendosjen e sinjalizimit dhe pajisjeve tjera të rrugës;

1.5. **Bermë** - hapësirë në mes të rigollës dhe skarpates së gërmimit dhe e cila shërben për mbrojtjen e rigollës prej materialit të eroduar, vendosjen e shenjave të trafikut e pajisjeve dhe sigurimin e dukshmërisë së rrugës;

1.6. **Brez mbrojtës** - sipërfaqja jashtë brezit tokësor në të dy anët e rrugës në të cilin nuk lejohet ndërtimi i objekteve e që fillon nga skaji i jashtëm i brezit rrugor;

1.7. **Brez rrugor** - brezi tokësor në të dy anët e rrugës i cili i takon kësaj rruge gjerësia e të cilit jashtë vendbanimit, për autoudhë, rrugë nacionale dhe rajonale është së paku dy (2) metra, ndërsa për rrugë lokale është së paku një (1) metër, duke e matur nga pikat e skajshme të profilit tërthort të rrugës dhe nga skaji i jashtëm i kanalit për largim të ujërave;

1.8. **Dukshmëri e nevojshme në udhëkryq** - përcaktohet në bazë të kushteve të trafikut rrugor në udhëkryq dhe në bazë të rregullave ligjore e teknike që rregullojnë konstruktimin e zonave të nevojshme të dukshmërisë në udhëkryqe dhe heqjen e pengesave që mund të rrezikojnë qarkullimin rrugor;

1.9. **Dukshmëri e nevojshme** - dukshmëria për ndalje të sigurt të automjeteve para pengesave të palëvizshme në shiritin për qarkullim rrugor e cila duhet të sigurohet në secilën pikë të rrugës dhe e cila përcaktohet në bazë të vlerës së shpejtësisë së projektuar;

1.10. **ISRr** - Inspektimi i sigurisë rrugore.

1.11. **Konstruksioni i rrugës** - është bazë mbi të cilin vendoset shtresa e epërme dhe shërben për të kapërcyer pengesat e ndryshme të terrenit dhe për transmetimin e ngarkesave nga ndikimet mekanike të automjeteve e të njëjtat t'i përcjell në pjesën e poshtme të rrugës, të mundësoj qarkullim të sigurt të automjeteve, biçikletave dhe këmbësorëve. Shtresa e epërme e konstruksionit të rrugës është shtresa qarkulluese;

1.12. **Kyçje në rrugë** - pjesa e rrugës me të cilën ndonjë sipërfaqe për qarkullim të automjeteve lidhet me rrugën publike përveç autoudhëve, prandaj në bazë të këtij Ligji kyçja nënkupton sipërfaqen që i mundëson automjeteve të kyçen në rrugë publike;

1.13. **Mbikalim** - objekte rrugore mbi rrugën publike për kryqëzim në dy nivele me rrugën, përkatësisht sistemin infrastrukturor;

1.14. **Ministria** - Ministria përkatëse për Infrastrukturë;

1.15. **Mirëmbajtja e jashtëzakonshme** - aktivitetet e herëpashershme që bëhen me qëllim të ngritjes së cilësisë së pjesëve të caktuara të rrugës publike, duke mos ndryshuar elementet teknike të rrugës, ruajtjen e sigurisë së qarkullimit rrugor, stabilitetin dhe qëndrueshmërinë afatgjate të rrugës dhe objekteve të rrugës;

1.16. **Mirëmbajtje e rregullt** - një mori masash dhe aktiviteteve që ndërmerren gjatë tërë vitit në mirëmbajtjen e rrugëve publike, duke përfshirë të gjitha objektet dhe pajisjet që janë në funksion të rrugës, me qëllim të sigurisë së qarkullimit rrugor;

1.17. **Rehabilitim i rregullt** - një mori masash dhe aktiviteteve që bëhen në një periudhë kohore në rrugët publike, duke përfshirë të gjitha objektet dhe pajisjet që janë në funksion të rrugës, me qëllim të sigurimit komod të qarkullimit dhe të sigurisë rrugore dhe të cilat janë të kategorizuara si investime kapitale sipas ligjeve në fuqi;

1.18. **Ndërtimi** - nënkupton kryerjen e të gjitha aktiviteteve të ndërtimit të ri të rrugës dhe objekteve tjera strukturore përcjellëse të rrugës;

1.19. **Nënkallim** - objekte rrugore nën rrugën publike për kryqëzim në dy nivele me rrugën, përkatësisht me sistemin infrastrukturor;

1.20. **Objekt dhe pajisje për largimin e ujërave** - për mbledhjen, largimin e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore për mbrojtjen e rrugës publike;

1.21. **Objekt përcjellës i rrugës publike** - hotelet, motelet, restorantet, serviset, pikat e karburantit, dyqanet, objektet për rekreacion dhe objektet tjera që kanë për qëllim ofrimin e shërbimeve të ndryshme të shfrytëzuesëve të rrugës publike;

- 1.22. **Objekt strukturor rrugor** - urat, mbikalimet, nënkalimet, viaduktet, akvaduktet, lëshesat, tunelet, galeritë, muret mbrojtëse dhe të ngjashme;
- 1.23. **Rigollë** - element i rrugës publike i cili bën largimin e kontrolluar të ujërave sipërfaqësore nga rruga dhe siguron stabilitet të konstruksionit të rrugës;
- 1.24. **Rregullativat teknike** - standardet, rregullat teknike, udhëzimet, kushtet dhe specifikimet për planifikim, projektim, ndërtim, mirëmbajtje dhe mbrojtje të rrugëve publike;
- 1.25. **Rrugë e pakategorizuar**- është çdo sipërfaqe për trafik e cila nuk është kategorizuar si rrugë publike dhe në të cilën zhvillohet trafiku sipas kushteve të cilat në pajtim me dispozitat mbi sigurinë e trafikut rrugor i ka paraparë pronari ose subjekti i autorizuar nga ai siç janë: rrugët malore, rrugët hyrëse në objekte ose në toka, sipërfaqet funksionale të trafikut skaj objekteve, stacionet e autobusit, rrugët në pronësi të posaçme dhe të ngjashme;
- 1.26. **Rrugë jashtë vendbanimit** - pjesë e rrugës jashtë kufijve të vendbanimit;
- 1.27. **Rrugë lidhëse** - rrugë publike e cila lidhë vendbanimet me stacionet hekurudhore, rrugët për aeroport, banjë shëruuese, qendra rekreative, parqe nacionale, monumentet dhe komplekset historike dhe të ngjashme;
- 1.28. **Rrugë lokale** - nënkupton rrugën publike zyrtarisht të kategorizuar si rrugë lokale, që lidhë hapësirat e banueshme brenda vendbanimeve të një komune ose pjesë të dy komunave të ndryshme;
- 1.29. **Rrugë nacionale** - nënkupton rrugën publike zyrtarisht të kategorizuar si rrugë nacionale e cila lidhë dy e më tepër qytete dhe e cila mund të shërbej si lidhje me rajonet jashtë Kosovës;
- 1.30. **Rrugë në lagje** - rrugë publike brenda vendbanimit e cila lidhë pjesë të vendbanimit;
- 1.31. **Rrugë në vendbanim** - pjesë e rrugës publike brenda kufijve të vendbanimit, karakteristikat e së cilës përcaktohen me plan hapësinor, përkatësisht plan urbanistik të komunës;
- 1.32. **Rrugë publike** - rrugë e kategorizuar si rrugë publike shtetërore ose komunale ku secili pa pengesa mund ta përdorë sipas kushteve të parapara me këtë ligj;
- 1.33. **Rrugë rajonale** - nënkupton rrugën publike zyrtarisht të kategorizuar si rrugë rajonale e cila lidhë qendrat me rëndësi ekonomike të dy apo më tepër komunave.
- 1.34. **Rrugë qarkore** - është pjesë e rrugës publike e kategorizuar si pjesë e rrugës nacionale, rajonale ose lokale e cila zëvendëson rrugën nëpër vendbanim ose segmentin rrugor nëpër qytet;

1.35. **Segmentet rrugore nëpër qytet** - janë pjesë e rrugës nacionale, rajonale, lidhëse të cilat kalojnë nëpër qytet, kufijtë e së cilës janë të definuara dhe janë të shënuara me shenja të qarkullimit rrugor;

1.36. **Shënimi i rrugëve publike** - procedura e përcaktimit të kategorisë dhe pozitës hapësinore të rrugës të shprehura në kilometra-stacionazhet;

1.37. **Shirit mbrojtës** - element i rrugës publike i cili fizikisht ndanë qarkullimin e mjeteve të motorizuara nga qarkullimi i mjeteve të pa motorizuara;

1.38. **Shirit ndarës** - element i rrugës publike i cili në mënyrë fizike ndan shiritat qarkullues me drejtim të kundërt të qarkullimit dhe vendosjen e shenjave të qarkullimit dhe pajisjeve rrugore. Shiriti ndarës i cili ka gjerësi më të madhe se gjashtë (6) metra quhet brez ndarës;

1.39. **Shtresë qarkulluese** - sipërfaqja e ndërtuar e rrugës publike mbi të cilën zhvillohet trafiku, përbëhet prej shiritave për qarkullim dhe ndalim;

1.40. **Sinjalizim rrugor** - mjetet dhe pajisjet për përcjelljen, kontrollin, rregullimin dhe drejtimin e rrjedhës së trafikut;

1.41. **Sistem infrastrukturor** - përfshinë sistemet transportuese ujore, hekurudhore dhe të ngjashme, dhe sistemet e furnizimit me ujë, kanalizimi, linjat e nxehtësie qendrore, furnizimi me gaz, furnizimit me rrymë, të telekomunikacionit, e të ngjashme;

1.42. **Sistemi Inteligent i Transportit - SIT** - paraqet sistemin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimeve në trafik rrugor i cili ka të bëjë me rrugët, automjetet dhe pjesmarrësit tjerë në trafik dhe shfrytëzohet për menaxhimin e trafikut dhe mobilitetit, aksidenteve dhe incidenteve në trafik dhe për të gjitha llojet tjera të trafikut.

1.43. **Tejkalim i ngarkesës qarkulluese** - rritjen e ngarkesës qarkulluese përkohësisht ose në vazhdimësi të automjeteve të rënda apo gjysmë të rënda në rrugën publike apo në një pjesë të saj, si shkas i eksploatimit të xeheve minerale, prerjes së pyjeve, prodhimeve industriale, aktivitetet ndërtimore dhe veprimtari të ngjashme;

1.44. **TEN-T** - Rrjeti Trans Evropian i Rrugëve i cili përbëhet nga rrjeti bërthamë dhe gjithëpërfshirës;

1.45. **Toka rrugore** - nënkuptojmë sipërfaqen e pronës brenda vijës së shpronësimit e definuar sipas dokumentacionit kadastral;

1.46. **Transporti i jashtëzakonshëm** - transport ku automjetet tejkalojnë dimensionet, peshën vetjake apo ngarkesën ose masën totale të tyre, përkatësisht ngarkesën boshtore;

1.47. **Traseja e rrugës** - është aksi i përcaktuar i rrugës i tërhequr në projekt ose i shënuar në terren, i cili shërben si pikë fillestare për ndërtimin e rrugës;

1.48. **Udhëkryq** - sipërfaqe për qarkullim rrugor në të njëjtin nivel ose në nivele të ndryshme, ku kryqëzohen dy apo më tepër rrugë, pavarësisht formës së tij;

1.49. **Vendbanim** - tërësi hapësinore dhe funksionale e ndërtuar në atë mënyrë ku janë krijuar kushtet për jetë dhe punë, si dhe janë krijuar kushte për nevoja të përbashkëta të banueseve, kufijtë e të cilit janë përcaktuar me plane hapësinore dhe urbanistike të komunës dhe janë të shënuara me shenja të qarkullimit rrugor;

1.50. **Vendkalim rrugë - hekurudhë** - vendi ku në të njëjtin nivel kryqëzohet rruga me hekurudhë;

1.51. **Vendndalim i autobusit** - pjesa e një sipërfaqeje të rrugës që shërben për ndalje të autobusëve me qëllim që të hyjnë dhe të dalin udhëtarët dhe që është e shënuar me shenjë përkatëse të trafikut;

1.52. **Vijë e ndërtimit** - vija brenda së cilës kryhen aktivitetet gjatë ndërtimit, rindërtimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve publike;

1.53. **Rehabilitim dhe Rindërtim** - nënkupton kryerjen e punimeve në rrugën ekzistuese dhe objektet tjera përcjellëse, me këto veprime të kryera ndërrohen elementet bazë të rrugës ose elementet konstruktive të strukturave (urave, mbikalimeve, nënkalimeve) me qëllim të përmirësimit të elementeve të rrugës dhe ngritjes së nivelit të shërbimeve në rrugë;

1.54. **Rrugë turistike** - rrugë publike që lidhë rrugën nacionale apo rajonale me zonën e identifikuar si turistike;

1.55. **Rrethrotullim** - vendi ku takohen dy ose më shumë rrugë, duke formuar një rreth që i gjithë trafiku duhet të ecë në të njëjtin drejtim;

1.56. **Kontratë e Infrastrukturës** - të gjitha kontratat e nënshkruara nga Ministria.

1.57. **Autoritet Kontraktues** - Ministria përgjegjëse për infrastrukturë.

1.58. **Nyje e autoudhës** - rruga përmes së cilës bashkohen dy ose më shumë autoudha ose autoudha lidhet me rrugën nacionale ose rajonale dhe e cila fillon nga ndarja me atë nacionale ose rajonale dhe përfundon me qasje në autoudhë.

1.59. **Strukturat rrugore** - në kuptim të këtij ligji janë: ura, viadukti, akuadukti, nënkalimi, mbikalimi, lëshesa, tuneli, galeria, muret mbrojtëse dhe të ngjashme;

1.60. **Strukturat** - në kuptim të këtij ligji janë objekte të përbëra nga një apo një apo më shumë pjesë të ndërtuara nga betoni, metali, druri, plastika apo materiali tjetër dhe të cilat janë të vendosura mbi sipërfaqen e tokës.

2.Termit të cilat përdoren në këtë ligj dhe nuk janë të përkufizuara në paragrafin 1 të këtij neni e kanë kuptimin sipas përkufizimeve në ligjet tjera.

Neni 4 **Statusi juridik i rrugëve publike**

1. Rrugët publike janë në pronësi të Republikës së Kosovës:
 - 1.1. ministria është përgjegjëse për: autoudhë, rrugë nacionale, rrugë rajonale dhe rrugë lidhëse;
 - 1.2. komuna është përgjegjëse për rrugë lokale.
2. Rruga publike shpallet për përdorim pas lëshimit të lejes së përdorimit.
3. Të drejtat për shfrytëzim dhe të drejtat për ndërtim në rrugën publike regjistrohen në kadastër.

Neni 5 **Elementet përbërëse të rrugës publike**

1. Rrugën publike e përbëjnë:
 - 1.1. trupi i rrugës, i cili përbëhet prej konstruksionit të poshtëm dhe konstruksionit të epërm të rrugës:
 - 1.1.1. konstruksioni i poshtëm i rrugës përfshin: nënbazën, mbushjen, gërmimin, objektet dhe pajisjet për largimin e ujërave dhe mbrojtjen nga ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore nga rruga, e të ngjashme;
 - 1.1.2. konstruksioni i epërm i rrugës përfshin: shiritin qarkullues, skajoret, rigollat, bankinat, bermat, shiritat ndarës dhe të ngjashme.
 - 1.2. strukturat rrugore: ura, viadukti, akuadukti, nënkalimi, mbikalimi, lëshesa, tuneli, galeria, muret mbrojtëse dhe të ngjashme;
 - 1.3. kyçja në rrugë publike të ndërtuara në tokën rrugore;
 - 1.4. trotualet, shtigjet për këmbësorë dhe biçikleta;
 - 1.5. brezi i rrugës i cili shtrihet në të dy anët e rrugës, shërben për mirëmbajtje të papenguar të rrugës dhe ka gjerësi sipas projektit;
 - 1.6. hapësira ajrore mbi rrugët në lartësi prej shtatë,zero (7,0) metra, profili i lirë mbi rrugët nacionale dhe rajonale në lartësi prej katër,pesëdhjetë (4,50) metra kurse për autoudhë katër,shtatëdhjetëepesë (4,75) metra nga sipërfaqja qarkulluese;
 - 1.7. objektet në tokën rrugore, për nevoja të mirëmbajtjes së rrugës dhe ofrimin e shërbimeve për drejtues të mjeteve dhe udhëtarëve si dhe pagesat e rrugës të cilat janë të parapara me projekt të rrugës;
 - 1.8. toka rrugore është sipërfaqja e tokës e cila sipas projektit duhet të ndërtohet apo është e ndërtuar rruga. Sipërfaqja e brezit rrugor po ashtu është sipërfaqja e tokës ku sipas projektit duhet të ndërtohen objekte për nevoja të mirëmbajtjes dhe ofrim të shërbimeve për drejtuesit e mjeteve dhe udhëtarëve si dhe pagesat për rrugë të parapara me projekt të rrugës siç janë: objektet për mirëmbajtje të rrugës, menaxhimi

dhe mbikëqyrja e rrugëve, pagesat rrugore, pikat e karburantit, serviset e ndryshme, vendparkimet, pushimoret dhe të ngjashme;

1.9. pajisjet matëse fikse dhe pajisje tjera për kontroll të automjeteve;

1.10. shenjat e trafikut, pajisjet për monitorim dhe zhvillim të qarkullimit rrugor dhe pajisjeve të rrugës siç janë trupat ndriçuese, pajisjet stabile të telekomunikacionit, instalimet dhe ndriçimi në funksion të trafikut rrugor, numëruesit e automjeteve, shenjat e rrugëve, instalimet e ndryshme, pajisjet në tunele, në vendparkime dhe të ngjashme;

1.11. objektet dhe pajisjet për mbrojtje të rrugës dhe mjedisit siç janë mbrojtësit e borës, mbrojtësit e erës, udhërrëfyesit, shenjat e stacionazheve, mbrojtësit e skarpateve nga shembja dhe erodimet, mbrojtësit e trafikut dhe parmakët për këmbësorë, mbrojtësit nga zhurmat dhe ndikimeve tjera me efekte negative për mjedisin dhe të ngjashme.

2. Rruga publike përveç elementeve nga paragrafi 1 i këtij neni, përfshin objekte dhe pajisje për rregullimin e trafikut.

Neni 6 Ndryshimi i statusit të rrugës publike

1. Nëse paraqitet nevoja e ndërprerjes së shfrytëzimit të rrugës publike ose një pjese të saj, mund t'i hiqet statusi i saj si pasuri publike për përdorim të përgjithshëm, patundshmëria të cilës i hiqet ky status mbetet pasuri shtetërore për përdorim të përgjithshëm, në pronësi të Republikës së Kosovës.

2. Propozimin për heqje të statusit të pasurisë publike për interes të përgjithshëm të rrugës ose një pjese të saj e inicion ministria ose komuna përkatëse, ndërsa vendimin për heqje të statusit të rrugës apo ndonjë pjese të saj e nxjerr Qeveria e Republikës së Kosovës.

Neni 7 Kategorizimi i rrugëve publike

1. Rrugët publike varësisht nga rëndësia e tyre shoqërore, ekonomike dhe e qarkullimit, kategorizohen në:

1.1. autoudhë;

1.2. rrugë nacionale;

1.3. rrugë rajonale;

1.4. rrugë lidhëse;

1.5. rrugë lokale.

1.6. rrugë të pakategorizuar

2. Për rrugët nga nënparagrafët 1.1., 1.2., 1.3. dhe 1.4. të paragrafit 1 të këtij neni, kriteret, kushtet, procedurat, evidenca, emërtimi, shënimi dhe aktivitetet tjera lidhur me kategorizimin e rrugëve publike përcaktohen me akt nënligjor nga ministria, ndërsa për rrugët nga nënparagrafët 1.5. dhe 1.6. të paragrafit 1 të këtij neni përcaktohen me akt nënligjor nga komuna.

Neni 8 Taksa rrugore

1. Për shfrytëzimin e rrugëve publike apo strukturave të veçanta në to, mund të aplikohet pagesë e veçantë e autoudhës, apo shfrytëzimin e strukturave të veçanta: urë, tunel, viadukt dhe të ngjashëm.

2. Mënyrën, procedurat, lartësinë dhe segmentet apo strukturat rrugore, shfrytëzimi i të cilave bëhet me pagesë sipas paragrafit 1 të këtij neni e përcakton Qeveria me akt nënligjor.

Neni 9 Standardet e rrugëve publike

1. Rrugët publike duhet të jenë të projektuara, ndërtuara, rindërtuara dhe të mirëmbajtura sipas standardeve në fuqi.

2. Standardet e projektimit, ndërtimit, rindërtimit dhe mirëmbajtjes i përcakton ministria.

Neni 10 Procedura për lëshimin, pezullimin dhe revokimin e lejes

1. Lejen për ndërtim dhe pëlqimet e nevojshme mjedisore i lëshon Ministria përgjegjëse për ndërtim/mjedis;

2. Lejen për rindërtim, apo zgjerim të rrugëve: autoudhës, rrugës nacionale, rajonale, lidhëse dhe objekteve tjera përcjellëse, e jep ministria.

3. Lejen për ndërtimin apo rindërtimin e rrugëve lokale dhe objektet tjera përcjellëse në to, e jep komuna.

4. Rregullat, procedurat dhe kushtet tjera lidhur me to, për lëshimin, pezullimin dhe revokimin e lejeve të përcaktuara në paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni, përcaktohen me akt nënligjor nga ministria.

Neni 11 Strategjia e zhvillimit të rrugëve publike

1. Qeveria e Republikës së Kosovës me propozimin e Ministrisë aprovon strategjinë me të cilën përcakton orientimet dhe planin zhvillimor të rrugëve publike në Republikën e Kosovës.

2. Strategjia për planin zhvillimor të rrugëve publike në Republikën e Kosovës përmban:

2.1. analizën e gjendjes së autoudhës, rrugës nacionale, rajonale, lidhëse dhe lokale, si dhe nevojën për zhvillimin e këtyre rrugëve;

2.2. nevojën për sinjalizimin e autoudhës ekzistuese, rrugës nacionale, rajonale, lidhëse dhe lokale;

2.3. nevojën për mirëmbajtjen e rrugëve publike, parimet e mirëmbajtjes dhe propozimin e kriterëve për prioritetet për mirëmbajtjen e autoudhëve, rrugëve nacionale, rajonale, lidhëse dhe lokale.

Neni 12

Infrastruktura komunale, linjat energjetike dhe telekomunikacioni

1. Nëse gjatë ndërtimit apo rindërtimit të rrugëve publike parashihet ndërtimi apo rindërtimi i infrastrukturës komunale, linjave energjetike dhe të telekomunikacionit dhe lidhja e tyre me rrugën publike e cila në tërësi apo pjesërisht janë në shërbim të rrugës publike, projekti duhet të përfshij edhe punët ndërtimore që do të realizohen në sipërfaqe, përkatësisht mbi dhe nën sipërfaqen e rrugës.

2. Themelimi i të drejtës për shfrytëzim apo të drejtës së ndërtimit të infrastrukturës dhe obligimet e investitorit të linjave energjetike dhe të telekomunikacionit dhe pajisjeve tjera përcjellëse nga paragrafi 1 i këtij neni, po ashtu edhe të drejtat dhe obligimet e Agjencisë, përcaktohen me marrëveshje.

3. Miratimin për ndërtimin e infrastrukturës komunale të linjave energjetike, të telekomunikacionit dhe pajisjeve të tjera përcjellëse në rrugën publike të cilat shërbejnë për nevoja të rrugës publike i jep Agjencia.

4. Nëse gjatë ndërtimit apo rindërtimit të rrugës publike, haset në infrastrukturën ekzistuese të linjave të ujit, energjetike, të telekomunikacionit dhe pajisjet tjera përcjellëse, shpenzimet e hartimit të projektit për ndërtimin dhe rindërtimin e kësaj infrastrukture i takojnë investitorit të rrugës publike, nëse personi i cili në bazë të ligjit të veçantë është i autorizuar të mbikëqyrë me atë ndërtim të rrugës publike për ndërtimin ekzistues, i ka prezantuar dokumentacionin në bazë të rregullave që rregullojnë ndërtimin. Në të kundërtën shpenzimet i bartë personi i cili në bazë të ligjit të veçantë është i autorizuar të menaxhoj me atë ndërtim.

Neni 13

Punët e sinjalizimit, pajisjeve dhe ndriçimit rrugor

Përshkrimin e punëve të sinjalizimit, pajisjeve dhe ndriçimit rrugor, specifikimin e punëve të caktuara dhe afateve për realizimin e këtyre punëve, rregullat dhe kushtet teknike për ekzekutimin e punëve dhe të gjitha çështjet tjera lidhur me to, i përcakton Ministria me akt nënligjor, ndërsa për rrugët nën përgjegjësin e komunës, rregullat i përcakton komuna me rregullore të veçantë.

Neni 14

Punët e mirëmbajtjes të rrugëve publike dhe objekteve përcjellëse

Përshkrimin e punëve të mirëmbajtjes, specifikimin e punëve të caktuara dhe afateve për realizimin e këtyre punëve, rregullat dhe kushtet teknike për ekzekutimin e punëve dhe të gjitha çështjet tjera lidhur me to, i përcakton Ministria me akt nënligjor, ndërsa për rrugët nën përgjegjësin e komunës, rregullat i përcakton komuna me rregullore të veçantë.

Neni 15

Punët tjera në menaxhimin e rrugëve publike

1. Punët tjera në menaxhimin e rrugëve publike janë:

- 1.1. njoftimi i publikut për gjendjen dhe kalueshmërinë në rrugë, ngjarjet e jashtëzakonshme dhe mbi kushtet meteorologjike për qarkullim të sigurt rrugor;
- 1.2. vendimmarrja për shfrytëzimin e tokës rrugore për ushtrimin e veprimtarive përcjellëse në rrugë;
- 1.3. organizimi i sistemit të pagesave rrugore në autoudhë dhe objektet me pagesë rrugore;
- 1.4. monitorimi dhe analiza e gjendjes së sigurisë rrugore në rrugët publike;
- 1.5. hartimi i raporteve, elaborateve, ekspertizave dhe materialeve të ndryshme.

Neni 16

Sistemi informativ i rrugëve të Kosovës

1. Agjencia e Rrugëve të Kosovës është përgjegjëse dhe menaxhon me Sistemin Informativ të Rrugëve të Kosovës (SIRrK), mbi rrugët publike, asetet përgjatë rrugëve, infrastrukturën prekëse dhe pronat e paluajtshme.
2. Komuna e cila udhëheqë me rrugët nën përgjegjësin e saj është e obliguar që të dhënat nga baza e tyre mbi rrugët publike t'ia përcjellë Agjencisë për vendosjen e tyre në SIRrK.

Neni 17

Mbrojtja e rrugëve publike

1. Rrugët publike përdoren për qarkullim rrugor, ndërsa për qëllime tjera vetëm sipas mënyrës dhe kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe dispozitat të cilat e rregullojnë sigurinë e qarkullimit rrugor.
2. Me qëllim të mbrojtjes së rrugëve publike dhe sigurinë e qarkullimit rrugor është e ndaluar që kushdo qoftë të:
 - 2.1. dëmtoj, largoj, zhvendos ose në ndonjë mënyrë tjetër ndërroj gjendjen ekzistuese të sinjalizimit rrugor, pajisjeve rrugore dhe të ngjashme;
 - 2.2. uzurpoj apo në një mënyrë tjetër të pengoj shfrytëzimin e rrugës publike apo një pjese të saj;
 - 2.3. ndërtoj, krijoj kyçje në rrugën publike pa pëlqimin e Agjencisë;
 - 2.4. shfrytëzoj apo ndërtoj çfarëdo strukture ndërtimore në tokën rrugore dhe pjesët përbërëse të saj pa pëlqimin e Agjencisë;

- 2.5. shkarkoj ujëra, ujëra të zeza, vajra motorike dhe rrjedha të tjera;
 - 2.6. pengoj kullimin e ujërave nga rruga;
 - 2.7. tërheq drunj dhe degë të drunjëve si dhe materiale dhe sende të ngjashme;
 - 2.8. lëshimi i kafshëve shtëpiake pa përcjellës në rrugë, lidhjen e kafshëve shtëpiake në kanal in për largim të ujërave apo kullotjen e kafshëve shtëpiake në tokën rrugore;
 - 2.9. vendos rrethoja, mbjell gardh, drunj dekorativ dhe të ngjashme;
 - 2.10. vendos grumbuj të drunjëve, materiale të ndryshme dhe sende të tjera;
 - 2.11. vendos pllaka të varrezave, lapidareve dhe përmendoreve të ndryshme;
 - 2.12. vendos pano të ndryshme reklamuese apo forma të tjera të informimit pa pëlqimin e Agjencisë;
 - 2.13. hedh material të ndryshëm betoni, vajit apo në çfarëdo mënyre bën ndotjen e rrugës publike;
 - 2.14. hedh borë apo akull në rrugë;
 - 2.15. qarkullimi në rrugë publike me goma të baltosura;
 - 2.16. bën punë tjera të cilat mund ta dëmtojnë rrugën publike ose të rrezikojnë sigurinë rrugore.
3. Me qëllim të mbrojtjes së rrugëve publike dhe qarkullimit rrugor në brezin mbrojtës të rrugës publike janë të ndaluara:
- 3.1. vendosja dhe përdorimi i dritave apo pajisjeve ndriçuese të cilat mund të rrezikojnë sigurinë e trafikut në rrugën publike;
 - 3.2. ndezja e qëllimshme e zjarrit dhe materiale që kundërmojnë në afërsi të rrugës publike;
 - 3.3. lëvrimi i tokës në distancë me të vogël se katër (4) metra nga skaji i tokës rrugore në drejtim të kundërt nga rruga publike ose në gjerësi një (1) metër nga skaji i tokës rrugore paralel me rrugën publike;
 - 3.4. vendosja e çfarëdo rrethoje, mbjellja e gardhit dhe drunjëve të tjerë të cilët pengojnë dukshmërinë e rrugës publike;
 - 3.5. lëshimi i kafshëve shtëpiake pa përcjellje;
 - 3.6. lënia e borës ose akullit që mund ta bëjë rrugën publike të rrëshqitshme;
 - 3.7. lënia e drunjëve dhe lëndët tjera dhe sendet që mund të bien në rrugë publike;
 - 3.8. shfrytëzimi i kycjes në rrugën publike pa pëlqim të Agjencisë;

3.9. ndërtimi i çfarëdo objekti apo strukture pavarësisht destinimit të saj;

3.10. të bëjnë punë të tjera të cilat mund ta dëmtojnë rrugën publike ose të rrezikojnë sigurinë rrugore.

4. Personi i autorizuar i ministrisë për inspektimin e rrugëve publike duhet të ndërmarrë të gjitha masat për largimin e pengesave nga rruga publike menjëherë pas kuptimit të paraqitjes së pengesave që mund ta dëmtojnë, pengojnë ose zvogëlojnë sigurinë rrugore.

5. Nëse përmes kontratave ekzistuese për mirëmbajtje, sinjalizim, ndërtim ose të ngjashme, nuk mundet t'a largoj menjëherë pengesën ose vendin e rrezikshëm në rrugën publike, atëherë duhet t'a siguroj pengesën me sinjalizimin përkatës për të informuar pjesëmarrësit në trafik dhe inspektorin kompetent.

6. Nëse në afërsi të rrugës publike apo objekteve rrugore bëhet minimi (gurëthyes dhe të ngjashëm), kryesi i punëve përkatësisht subjekti i cili eksploaton këtë objekt, duhet që përveç vendosjes së shenjave të trafikut, të siguroj diametrin në largësi së paku pesëqind (500) metra nga vendi i cili do të minohet. Mbikëqyrjen e tërë procesit të minimimit do ta bëjnë personat e specializuar të cilët me shenja përkatëse do të rregullojnë sigurinë e trafikut.

Neni 18 **Transporti i jashtëzakonshëm**

1. Personi fizik, personi fizik i cili ushtron biznes individual dhe personi juridik i cili ushtron veprimtarinë e transportit të jashtëzakonshëm janë të obliguar që të pajisen me leje për transport të jashtëzakonshëm, të cilën e lëshon Ministria.

2. Të gjitha automjetet e rënda me peshë të përgjithshme me të madhe se katërdhjetë (40) ton, duhet të pajisen me leje për transport të jashtëzakonshëm, përpos kontejnerëve ISO standard deri në katërdhjetë (42) ton me pesë (5) akse ose katërdhjetëkatër (44) ton me gjashtë (6) akse.

3. Të gjitha automjetet transportuese të cilat e kalojnë peshën e lejuar: gjatësinë, gjerësinë, lartësinë, peshën e përgjithshme dhe peshën boshtore duhet të pajisen me leje për transport të jashtëzakonshëm:

3.1. gjatësia më e madhe e lejuar tetëmbëdhjetë, shtatëdhjetëepesë (18,75) metra;

3.2. gjerësia më e madhe e lejuar dy, gjashtëdhjetë (2,60) metra;

3.3. lartësia më e madhe e lejuar katër (4,00) metra;

3.4. pesha më e madhe lejuar katërdhjetë (40) ton.

4. Zyrtarët e autorizuar i përdorin pajisjet për kontrollin e peshave, e sipas nevojës mund t'i shfrytëzojnë edhe pajisjet për matjen e mbipeshave në терминаlet e licencuara:

- 4.1. nëse automjeti transportues nuk e ka tejkeluar peshën e lejuar sipas këtij ligji, transportuesi është i liruar nga pagesa;
 - 4.2. nëse tejkalohej peshë mbi dhjetë (10) përqind e peshës së lejuar, automjeti largohet nga trafiku derisa ta rregulloj peshën që lejohet me ligj.;
 - 4.3. largimi i automjetit nga trafiku bëhet në vendparkingun më të afërt nga vendi i verifikimit të matjes.
5. Ministria me akt nënligjor përcakton kushtet, kriteret dhe procedurat për marrjen e lejes për transport të jashtëzakonshëm sipas paragrafit 1 të këtij neni.
 6. Mbikëqyrjen e zbatimit të këtij neni e kryen zyrtari i autorizuar i Agjencisë në bashkëpunim dhe asistencë të Policisë së Kosovës.
 7. Dispozitat e këtij neni nuk vlejné për Forcat e NATO-së, FSK-në dhe Policinë e Kosovës.

Neni 19 **Kyçja në rrugë publike**

1. Personi fizik, personi fizik i cili ushtron biznes individual dhe personi juridik, ndërtimin dhe përdorimin e kyçjes në rrugë publike mund ta bëjë vetëm me miratimin e Agjencisë.
2. Kushtet, kriteret dhe procedurat për lëshimin, pezullimin dhe revokimin e lejes për ndërtim dhe përdorim të kyçjes për rrugët nën përgjegjësinë e ministrisë i cakton ministria me akt nënligjor, ndërsa për rrugët nën përgjegjësinë e komunave i përcakton komuna me akt nënligjor.
3. Kryqëzimi i rrugëve publike në mes veti, si dhe në mes të rrugëve publike dhe rrugëve të pakategorizuara nuk konsiderohet kyçje në rrugë publike.
4. Kyçja në autoudhë duke përfshirë edhe rrugët e nyjeve të autoudhës është e ndaluar.
5. Personat të cilët realizojné kyçje në rrugën publike në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji si dhe personat të cilët e shfrytëzojnë kyçjen e realizuar në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, nuk kanë të drejtë në kompensim të çfarëdo dëmi i cili mund të shkaktohet nga përdorimi i kësaj kyçjeje, nga Agjencia.
6. Në rast të ndërtimit të kyçjes pa pëlqim, Agjencia ka të drejtë ta rrënojë çdo ndërtim apo strukturë në brezin rrugor apo mbrojtës të rrugës publike si dhe të kërkoj kompensim për shpenzimet e rrënimit të kyçjes së ndërtuar pa pëlqim.
7. Objektet e ndërtuara në brezin mbrojtës rrugor do të trajtohen sipas Ligjit përkatës për trajtimin e ndërtimeve pa leje.

Neni 20 **Përshtatja e kyçjes në rrugë publike**

1. Nëse kyçja në rrugët publike për shkak të trafikut të rritur ose shfrytëzimit për trafik tjetër nga ai që është marrë parasysh me rastin e dhënies së pëlqimit për ndërtimin e tij nuk është

përkatës, atëherë Agjencia do të kërkoj përshtatjen e kyçjes duke i ndërruar kushtet e rindërtimit.

2. Shpenzimet e përshtatshmërisë së kyçjes i bartë personi i autorizuar i drejtës së ndërtimit ose pronari i cili lidhet në rrugën publike.

Neni 21 **Vendndalja e autobusit**

Përveq autoudhës, në rrugët tjera nën përgjegjësin e ministrisë, kushtet për përcaktimin e lokacionit, kushtet për projektimin dhe ndërtimin e vendndaljes së autobusit përcaktohen me akt nënligjor nga ministria, ndërsa komuna për rrugët nën përgjegjësin e saj.

Neni 22 **Zhvendosja e rrugës publike**

1. Nëse për shkak të ndërtimit të objekteve tjera me interes publik, infrastrukturës hekurudhore, miniera, gurëthyes, liqe akumulues, aeroport, dhe të ngjashme, duhet të zhvendoset rruga ekzistuese publike apo një pjesë e saj, e njëjta përkatësisht pjesa e saj e cila do të zhvendoset duhet të jetë e projektuar dhe e ndërtuar me elemente së paku të njëjta teknike si para zhvendosjes.

2. Vendimin për lejimin e zhvendosjes së rrugës publike, të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, e nxjerr ministria për rrugët nën përgjegjësin e saj, përkatësisht komuna për rrugët nën përgjegjësin e saj.

3. Shpenzimet e zhvendosjes së rrugës publike, përkatësisht të pjesës së saj i bartë investitori i objektit i cili kërkon zhvendosjen e rrugës publike përkatësisht pjesës së saj, nëse ndryshe nuk është paraparë me marrëveshje.

Neni 23 **Brezi mbrojtës i rrugës publike**

1. Në mënyrë që të parandalohen efektet e dëmshme të shkeljeve në hapësirën përgjatë rrugës dhe trafikut në të, do të ketë një zonë mbrojtëse përgjatë këtyre rrugëve në të cilën kufizohet përdorimi i hapësirës.

2. Në hapësirën e përcaktuar për brez mbrojtës rrugor nuk mund të hapet minierë, ndërtohen liqe artificial, objekte industriale, fabrika dhe struktura ndërtimore të ngjashme.

3. Brezi mbrojtës në kuptimin e paragrafit 2 të këtij neni matet nga skaji i jashtëm i brezit rrugor, kështu që nga të dy anët ka gjerësinë për:

- 3.1. autoudhë, njëqind (100) metra;
- 3.2. rrugë nacionale, gjashtëdhjetë (60) metra;
- 3.3. rrugë rajonale dhe lidhëse, dyzetë (40) metra;
- 3.4. rrugë lokale, tridhjetë (30) metra.

4. Në hapësirën e përcaktuar për brez mbrojtës rrugor nuk mund të ndërtohen objekte, struktura, rezidenca, zyre, puse, gropa septike, shtylla elektrike dhe instalime të ngjashme.

5. Brezi mbrojtës në kuptimin e paragrafit 4 të këtij neni matet nga skaji i jashtëm i brezit rrugor, kështu që nga të dy anët ka gjerësinë për:

5.1. autoudhë, njëqindë (100) metra;

5.2. rrugë nacionale, tridhjetë (30) metra;

5.2.1. përjashtimisht nga nënparagrafi 5.2 i këtij neni, për rrugët e definuara si "rrugë në vendbanim" dhe "segmentet rrugore nëpër qytet" distanca është pesëmbëdhjetë (15) metra.

5.3. rrugë rajonale dhe lidhëse, dhjetë (10) metra;

5.4. rrugë lokale, pesë (5) metra.

6. Çdo person fizik dhe juridik i cili ndërton objekt në parcelën e cila kufizohet me rrugë publike siç janë: autoudhë, rrugë nacionale, rajonale dhe lidhëse, paraprakisht duhet të pajiset me pëlqim nga Agjencia para marrjes së lejes së ndërtimit nga komuna përkatëse.

7. Leja për kyqje në rrugët nën përgjegjesin e ministrisë është kusht paraprak që komuna të lëshoj lejen për kushtet ndërtimore.

Neni 24 **Dukshmëria në rrugën publike**

1. Në afërsi të udhëkryqeve të rrugëve publike në të njëjtin nivel, kryqëzimit të rrugës publike me binarët hekurudhor në të njëjtin nivel, si dhe në anët e brendshme të ishujve të rrugës nuk lejohet të mbillen drunj, të vendosen pajisje, rrethoja apo objekte tjera të cilat pengojnë dukshmërinë në rrugën publike.

2. Pronarët apo shfrytëzuesit e tokës janë të obliguar që me kërkesë të Agjencisë, të largojnë drunjët, degët, objektet, rrethojat dhe objekte të ngjashme, për të siguruar dukshmëri të mjaftueshme në rrugën publike.

3. Nëse pronari, përkatësisht shfrytëzuesi i tokës nuk vepron sipas paragrafit 2 të këtij neni, Agjencia, shpenzimet për kryerjen e punëve i bartë te pronari ose te shfrytëzuesi i tokës.

Neni 25 **Objektet, pajisjet dhe instalimet përgjatë rrugës publike**

1. Pronari ose shfrytëzuesi i objekteve, pajisjeve dhe instalimeve për gjatë rrugës publike, të cilat janë dëmtuar dhe mund të shkaktojnë rrezik për rrugën publike, pjesëmarrësit në trafik dhe mjedis, duhet të njoftoj Agjencinë dhe organet ligj zbatuese përkatëse.

2. Pronari ose shfrytëzuesi i objekteve, pajisjeve dhe instalimeve nga paragrafi 1 i këtij neni, duhet mënjeluar dëmtimet duke eliminuar edhe rrezikun nga dëmtimi dhe për këtë duhet të njoftoj Agjencinë.

3. Pronari ose shfrytëzuesi i objekteve, pajisjeve dhe instalimeve nga paragrafi 2 i këtij neni, është i obliguar që t'ia kompensoj dëmin dhe shpenzimet tjera të cilat për shkak të dëmtimit të instalimeve dhe pajisjeve iu kanë shkaktuar rrugës publike si dhe të ndërmerr të gjitha masat për sigurimin e vendndërtimit për të qenë i sigurt për të gjithë pjesëmarrësit në trafik, duke respektuar standardet e sigurisë në fuqi.

Neni 26 **Reklamat pranë rrugës publike**

1. Në autoudhë, strukturat rrugore në autoudhë, brezin e autoudhës, dhe në brezin mbrojtës rrugor të saj nuk lejohet vendosja e reklamave, përveç në pushimoret e saj.

2. Në rrugët nacionale, rajonale dhe lidhëse është e ndaluar vendosja e reklamave në sipërfaqen e: tokës rrugore, brezit rrugor dhe brezit mbrojtës rrugor.

3. Në hapësirat tjera jashtë brezit mbrojtës rrugor të autoudhës, rrugës nacionale, rajonale dhe lidhëse nuk lejohet vendosja e reklamave në vendet ku për shkak të përmbajtjes, pozitës në raport me rrugën, reklama mund të rrezikojë sigurinë rrugore.

4. Në zbatim të paragrafit 3 të këtij neni ministria nxjerr akt nënligjor për rrugët nën përgjegjësinë e saj, ndërsa komuna për rrugët nën përgjegjësinë e saj.

Neni 27 **Mbyllja e rrugës publike**

1. Agjencia në rastet e veçanta mund të nxjerr vendim dhe mbyll rrugën publike ose të një pjesë të saj përkohësisht për qarkullim të tërësishëm ose të pjesëshëm pas vlerësimit mbi rrezikimin e sigurisë në trafik.

2. Aktivitetet sportive dhe manifestimet tjera në rrugët publike mund të organizohen sipas kushteve dhe mënyrës së përcaktuar të sigurisë së qarkullimit rrugor pas marrjes së pëlqimit nga Agjencia.

3. Publikimi i mbylljes së rrugës ose pjesës së saj duhet të bëhet së paku katërdhjetëtetë (48) orë para mbylljes. Nëse publikimi bëhet në më pak se katërdhjetëtetë (48) orë nga fillimi i mbylljes, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës duhet të shtohen masat e sigurisë në trafik.

Neni 28 **Shenjat e trafikut, sinjalizimi, pajisjet, shenjat turistike dhe sinjalizime tjera**

1. Shenjat e trafikut, sinjalizimi, pajisjet, shenjat turistike dhe sinjalizimet tjera vendosen në rrugët publike në bazë të projektit të trafikut.

2. Për të gjitha rrugët të cilat janë të ndërtuara pa projekt të trafikut, atëherë duhet të merret parasysh gjendja ekzistuese e sinjalizimit të trafikut dhe pajisjeve.

3. Elaborati i trafikut dorëzohet për procedim dhe miratim me qëllim të marrjes së vendimeve për ndërtim, rindërtim dhe mirëmbajtje të rrugëve publike.

4. Agjencia është e autorizuar të ndryshoj elaboratin e trafikut nga paragrafi 1 të këtij neni, përkatësisht gjendjen ekzistuese nga paragrafi 2 të këtij neni. Ky ndryshim do të bëhet në bashkëpunim edhe me autoritetet ligjzbatuese.

5. Ministria me akt nënligjor përcakton rregullat, procedurat dhe standardet për sinjalizimin horizontal dhe vertikal.

Neni 29

Kërkesat minimale për siguri në tunele

1. Kërkesat minimale të sigurisë në tunele në rrugë publike zbatohen në tunele më të gjatë se pesëqind (500) metra.

2. Minimumi i kërkesave të sigurisë për tunele nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të siguroj ndalimin e ngjarjeve kritike të cilat mund të kenë pasoja në rrezikimin e jetëve të njerëzve, mjedisit dhe instalimeve të tunelit si dhe mbrojtja në rast të ndonjë fatkeqësie.

3. Ministria në bashkëpunim me institucionet relevante, përcaktojnë kërkesat minimale të sigurisë në tunele nga faza e planifikimit, ndërtimit dhe përdorimit.

Neni 30

Shërbimet emergjente në tunele

Shërbime emergjente janë të gjitha shërbimet publike ose private të cilat janë pjesë përbërëse e punonjësve në tunele që ndërveprojnë në rast fatkeqësie, në bashkëpunim me zyrtarët policor, njësinë e zjarrfikësve dhe njësinë e shpëtimit.

Neni 31

Menaxhimi me tunele

1. Agjencia është autoritet publik për menaxhimin me tunele, vendosjen e parametrave të sigurisë dhe ndërmarrjen e veprimeve të domosdoshme për përmbushjen e nevojave minimale të sigurisë në tunele.

2. Agjencia në çdo moment mund të mbyll tunelin ose kufizoj qarkullimin e trafikut në tunel, nëse mungojnë masat e sigurisë për zhvillim normal të trafikut. Pas përmbushjes së kërkesave të sigurisë tuneli lëshohet në qarkullim.

3. Agjencia është e obliguar që:

- 3.1. rregullisht të inspektoj, shqyrtoj, zbatoj dhe të vendosë masat përkatëse të sigurisë në tunel;
- 3.2. të hartoj skema organizative të punës, duke përfshirë edhe planet në rast rreziku, trajnimin dhe pajisjen e shërbimeve emergjente;
- 3.3. përcaktimin e procedurave për mbylljen e tunelit në rast të rrezikut;
- 3.4. merr masa për zvogëlimin e rrezikut;
- 3.5. në rast nevojë të paraqes analizën e rrezikut, organit i cili ndikon në sigurinë, llojin e trafikut, gjatësinë dhe gjeometrinë e tunelit si dhe numri i paraparë i kalimeve ditore nga automjetet transportuese;
- 3.6. personi përgjegjës i organit sipas paragrafit 1 të këtij neni në raste të jashtëzakonshme apo ndonjë fatkeqësie e cila ndodh në tunel, harton raport i cili i dërgohet zyrtarit për siguri dhe ekipeve emergjent në afat prej tridhjetë (30) ditë nga dita e rastit, që është lëndë e raportit;
- 3.7. raporti me rezultatet e analizës së rrezikut dhe dokumentacioni i sigurisë, përcillet në ministri.

Neni 32 **Zyrtari për siguri në tunel**

1. Agjencia është e obliguar që për secilin tunel të emëroj zyrtarë për siguri, i cili do të koordinoj aktivitetet dhe masat mbrojtëse për të arritur siguri maksimale për pjesëmarrësit në trafik dhe personelin e tunelit.
2. Zyrtari për siguri emërohet nga radhët e personelit të tunelit ose të shërbimeve emergjente, duhet të jetë i pavarur në çështjet e sigurisë rrugore të tunelit dhe në këto çështje nuk duhet t'i nënshtrohet urdhrave të punëdhënësit.
3. Zyrtari për siguri mund të kryej detyrat dhe funksionet e tij në shumë tunele në një zonë.
4. Zyrtari për siguri është i obliguar që:
 - 4.1. të koordinoj punët me ekipet emergjente dhe të merr pjesë në përgatitjen planit të veprimit;
 - 4.2. të merr pjesë në hartimin e planeve të sigurisë dhe specifikimit të objekteve ndërtimore, pajisjeve dhe veprimet që kanë të bëjnë me tunelet e reja dhe modifikimi i atyre ekzistues;
 - 4.3. të verifikoj gatishmërinë e personelit të tunelit dhe ekipeve emergjente si dhe të merr pjesë në trajnime që organizohen rregullisht në intervale të caktuara kohore;

4.4. të jep sugjerime për futjen në qarkullim të objekteve, pajisjeve dhe lëshimin e tunelit në punë;

4.5. të verifikoj se konstruksioni ndërtimor dhe pajisjet mirëmbahen dhe riparohen;

4.6. të merr pjesë në vlerësimin e çdo rasti të aksidenteve, të fatkeqësive ose rrethanave të jashtëzakonshme.

Neni 33

Rastet e jashtëzakonshme apo fatkeqësia

Secili rast i jashtëzakonshëm ose fatkeqësi që ndodh në tunel duhet të jetë pjesë e raportit të cilin e përmbledh subjekti i cili menaxhon me tunel sipas këtij ligji. Raporti së bashku me konkluzionet duhet t'i dorëzohet Ministrit, Ministrit për Punë të Brendshme, Inspektorit dhe Shërbimeve Emergjente brenda një afati kohor jo më shumë se tridhjetë (30) ditë.

Neni 34

Inspektimi i tuneleve

1. Inspektori bën mbikëqyrjen e kërkesave minimale të sigurisë në tunele si dhe merr masa për eliminimin e mangësive të identifikuara.

2. Inspektori është funksionalisht i pavarur nga udhëheqësi i tunelit.

3. Mbikëqyrja inspektuese e tunelit bëhet se paku çdo pesë (5) vjet. Për mbikëqyrjen dhe ndërmarrjen e masave në tunel njoftohet Ministria, Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia dhe zyrtari për siguri.

4. Nëse me mbikëqyrjen inspektuese nga paragrafi 3 i këtij neni, konstatohet se tuneli nuk i përmbushë dispozitat e këtij Ligji, Inspektorati për këtë do të njoftoj me shkrim menaxherin e tunelit dhe zyrtarin për siguri, si dhe do të urdhëroj marrjen e masave për rritjen e sigurisë në tunel.

5. Agjencia pas gjetjeve të inspektorit dhe masave të ndërmarra nga ky nen, do të përcaktoj kushtet për hapje të serishme të tunelit.

Neni 35

Projektet me partneritet publiko-privat

Projektet e partneritetit publiko - privat, procedurat dhe të gjitha elementet lidhur me to, zbatohen sipas Ligjit përkatës për partneritetet publiko - privat.

Neni 36

Themelimi i Agjencisë së Rrugëve të Kosovës

Me këtë ligj themelohet Agjencia e Rrugëve të Kosovës (ARrK), si institucion publik në kuadër të Ministrisë përgjegjëse për rrugët e Kosovës.

Neni 37

Statusi i Agjencisë

1. Agjencia e Rrugëve të Kosovës ka statusin e agjencisë ekzekutive në pajtim me Ligjin përkatës për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura.

2. Agjencia e Rrugëve të Kosovës organizohet dhe funksionon në:

2.1. përputhje me dispozitat e këtij ligji;

2.2. përputhje me aktin nënligjor mbi organizimin e brendshëm të Agjencisë, i cili miratohet nga Kryeministri në bazë të propozimit të ministrit përgjegjës të linjës;

2.3. legjisllacionin në fuqi.

3. Selia kryesore e Agjencisë është në Prishtinë, ndërsa sipas nevojës mund të themelohen Departamente Rajonale.

Neni 38 Simbolet e Agjencisë

Simbolet e Agjencisë rregullohen me akt nënligjor.

Neni 39 Detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë janë si në vijim:

1.1. përmbushjen e detyrimeve sipas këtij ligji;

1.2. mirëmban dhe zbaton manualet për sinjalizim, rindërtim, ndërtim dhe mirëmbajtje të rrugëve të Kosovës;

1.3. përgatitë, mirëmban dhe zbaton rregullat për mbikëqyrje të kontratave të punës, shërbimeve dhe kontratave tjera në të cilat ministria është autoritet kontraktues, licencues apo çertifikues i aktivitetit të cilat kanë të bëjnë me aktivitetet në rrugë;

1.4. zbaton programe afatmesme zhvillimi dhe programin vjetor të punës për ndërtimin, rindërtimin, mirëmbajtjen, ruajtjen, dhe zhvillimin e rrugëve publike, në përputhje me planet e përcaktuara në dokumentet strategjike dhe të aprovuara nga ministri.

1.5. krijon dhe mirëmban SIRrK, sistemin për administrimin e rrugëve shtetërore dhe të urave;

1.6. propozon planin dhe politikat zhvillimore e afariste të Agjencisë;

1.7. propozon rregullat për funksionimin e Agjencisë;

1.8. propozon buxhetin dhe programet vjetore të Agjencisë;

1.9. kryen punë dhe detyra të përcaktuara me këtë ligj dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 40 **Udhëheqja dhe personeli i Agjencisë**

1. Agjencia drejtohet nga drejtori ekzekutiv i mbështetur nga një (1) zëvendës drejtor.
2. Emërimi, mandati, lirimi dhe shkarkimi i drejtorit dhe zëvendës drejtorit të Agjencisë bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për Pozitat të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës;
3. Drejtori ekzekutiv dhe zëvendës drejtori janë nëpunës civil të kategorisë së lartë drejtuese sipas Ligjit përkatës për zyrtarët publikë. Personeli i punësuar në Agjenci e ka statusin e nëpunësve civil sipas Ligjit përkatës për zyrtarët publikë.

Neni 41 **Funksionet e Drejtorit të Agjencisë**

1. Drejtori ekzekutiv drejton dhe përfaqëson Agjencinë dhe në mënyrë të veçantë është përgjegjës për:
 - 1.1. propozimin e planit dhe raportit vjetor të performancës së Agjencisë;
 - 1.2. menaxhimin e burimeve njerëzore të Agjencisë në pajtim me Ligjin përkatës për zyrtarët publikë;
 - 1.3. ekzekutimin e buxhetit dhe miratimin e pagesave sipas legjislacionit për menaxhimin e financave publike;
 - 1.4. lidhjen e kontratave në emër dhe për llogari të institucionit, në pajtim me ligjin;
 - 1.5. menaxhimin e pronës shtetërore, që i është besuar Agjencisë për administrim.
 - 1.6. çdo përgjegjësi tjetër që i caktohet me ligj.
2. Drejtori ekzekutiv mund t'ua delegojë detyrat e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, drejtuesve të njësive administrative të institucionit. Në këtë rast, ai mbetet përgjegjës për mbikëqyrjen e detyrave të deleguara.
3. Drejtori ekzekutiv krijon një regjistër, në të cilin përcaktohen aktet e delegimit, detyrat dhe fusha e delegimit, personit të cilit i është deleguar dhe periodha e vlefshmërisë të delegimit.

Neni 42 **Buxheti i Agjencisë**

1. Buxheti i Agjencisë është vijë buxhetore në kuadër të buxhetit të ministrisë, të miratuar në pajtim me Ligjin përkatës për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë;

2. Drejtori i Agjencisë përgatit buxhetin e Agjencisë, të cilin pastaj ia përcjell ministrit për shqyrtim dhe procedim të mëtutjeshëm në përputhshmëri me procedurat e parapara me ligj;
3. Drejtori i Agjencisë është përgjegjës për menaxhimin efektiv dhe efikas të buxhetit të Agjencisë, në pajtim me ligjin dhe me rregullat e brendshme buxhetore të Ministrisë;

Neni 43 **Sistemet inteligjente të transportit në trafikun rrugor**

1. Menaxhimi i trafikut në rrugë publike sigurohet përmes:

1.1. sistemit inteligjent të transportit (në tekstin e mëtejme SIT) i cili nënkupton sistemin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimeve në trafik rrugor i cili ka të bëjë me rrugët, automjetet dhe pjesëmarrësit tjerë në trafik dhe shfrytëzohet për menaxhimin e trafikut dhe mobilitetit, incidenteve në trafik dhe për të gjitha llojet tjera të trafikut.

1.2. sistemin e pajisjeve për pagesat e rrugës;

1.3. pajisjet e sigurisë në tunele;

1.4. aparatura dhe pajisjet për mbrojtjen e rrugës publike;

1.5. sinjalizimin e trafikut.

2. Agjencia zhvillon, mbikëqyrë dhe menaxhon SIT.

Neni 44 **Aplikimi i SIT**

1. SIT aplikohet në fushat me prioritet për zhvillimin dhe përdorimin e specifikimeve dhe standardeve si më poshtë:

1.1. përdorimi optimal i të dhënave për rrugët, trafikun dhe qarkullimin;

1.2. shërbimet e vazhdueshme të SIT-it për menaxhimin e trafikut dhe transportit rrugor;

1.3. aplikacionet e SIT-it për përmirësimin dhe rritjen e sigurisë rrugore dhe lidhshmëria e automjeteve me infrastrukturën e transportit.

2. Prioritet i aktiviteteve në kuadër të fushës nga paragrafi 1 i këtij neni janë:

2.1. informatat mbi qarkullimin;

2.2. informatat mbi sigurinë në trafik dhe regjimin e zhvillimit të trafikut;

2.3. informatat për trafik në kohë reale;

2.4. shërbimet e e-thirrjeve;

2.5. informatat për parkingje të sigurta;

2.6. shërbimet e rezervimit të vendparkimeve të sigurta për autobus dhe mjete të transportit të mallrave.

3. Menaxhimi i trafikut në rrugët publike duke aplikuar SIT në trafikun rrugor, ushtrohet sipas programit të vendosjes dhe zhvillimit të SIT në trafikun rrugor:

4. Programin nga paragrafi 3 i këtij neni e propozon ministria, ndërsa e miraton Qeveria për një periudhë pesë (5) vjeçare.

5. Ministria me akt nënligjor rregullon zbatimin e SIT për rrugët nën përgjegjësin e saj, ndërsa komuna me akt nënligjor për rrugët nën përgjegjësin e saj.

Neni 45 **Auditimi dhe inspektimi i sigurisë rrugore**

1. Auditimi i sigurisë aplikohet në TEN-T dhe rrugët nacionale.

2. Auditimi i sigurisë rrugore është një kontroll i pavarur, i detajuar, sistematik dhe teknik i sigurisë që i referohet karakteristikave të projektuara të projektit të infrastrukturës rrugore dhe që përfshin të gjitha fazat nga planifikimi deri te lëshimi në qarkullim.

3. Auditimi i sigurisë rrugore kryhet gjatë projektimit, ndërtimit përkatësisht rindërtimit dhe lëshimit në qarkullim të rrugëve, si dhe në periudhën fillestare të përdorimit të rrugës.

Neni 46 **Auditori i sigurisë rrugore**

1. Auditimi i projekteve të TEN-T, rrugëve nacionale dhe strukturave të lidhura me to, bëhet në përputhje me këtë ligj.

2. Auditimin e dokumentacionit projektues dhe dokumentacionit tjetër në kuadër të vlerësimit të sigurisë në rrugët TEN-T dhe nacionale në përputhje me dispozitat e këtij ligji e kryen auditori i sigurisë rrugore.

Neni 47 **Auditimi**

1. Auditori i sigurisë rrugore nuk mund të kryej auditimin e sigurisë rrugore për projektet dhe dokumentacionin në hartimin e të cilave ka marrë pjesë ose është në projektimin ose menaxhimin e rrugës publike për të cilën kryhet auditimi përfshirë edhe personin juridik në të cilin është i punësuar i njëjti.

2. Auditori i sigurisë rrugore kryen auditimin e sigurisë rrugore në përputhje me dispozitat e këtij ligji, aktet nënligjore, kërkesat teknike dhe rregullat e profesionit në lidhje me sigurinë rrugore.

3. Përvoja e punës dhe përgatitja profesionale për auditor të sigurisë rrugore, mënyra në të cilën e njëjta vërtetohet te lëshimi i autorizimit sipas këtij neni, programi dhe çertifikimi i aftësisë për auditor të sigurisë rrugore, programet e aftësisë shtesë, përmbajtja dhe mënyra

e mbajtjes së regjistrit të auditoreve, mënyra dhe shtrirja e kryerjes së punëve të auditimit të sigurisë rrugore dhe mënyra e llogaritjes së kompensimit për punët e kryera të auditimit të sigurisë rrugore i përcakton ministri me akt të nënligjor.

Neni 48

Vlerësimi i sigurisë së pjesëve të rrugëve TEN-T dhe nacionale me një numër të madh aksidentesh trafiku

1. Pjesa e rrugës TEN-T dhe nacionale me numër të madh të aksidenteve të trafikut është pjesa e rrugës në të cilën qarkullohet më gjatë se tre (3) vjet dhe në të cilën kanë ndodhur një numër i madh aksidentesh me persona të vdekur në raport me numrin e trafikut.
2. Agjencia, koncesionari janë të detyruar çdo tre (3) vjet për rrugët TEN-T dhe nacionale me të cilat administrojnë, të kryejnë vlerësimin e sigurisë së pjesëve të rrugëve me numër të madh të aksidenteve të trafikut. Vlerësimi i parë i sigurisë duhet të kryhet më së voni në afat prej pesë (5) vitesh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.
3. Vlerësimin e sigurisë së pjesëve të rrugëve TEN-T dhe nacionale me një numër të madh aksidentesh trafiku e kryejnë ekipe ekspertësh të cilët i emëron Agjencia, përkatësisht koncesionari, dhe të paktën një (1) anëtar i ekipit të ekspertëve duhet të jetë auditor i sigurisë rrugore.

Neni 49

Segmentet rrugore me rrezikshmëri të lartë

1. Segmentet e rrugës me rrezikshmëri të lartë, janë vendet e rrezikshme në infrastrukturën rrugore në të cilën kanë ndodhur së paku dy (2) aksidente të trafikut me vdekje apo lëndime, në gjatësi maksimale prej treqind (300) metra brenda zonës së vendbanimit, apo në gjatësi maksimale një mijë (1000) metra jashtë zonës së vendbanimit, për të cilat një nga shkaqet janë kushtet apo gjendja e rrugës.
2. Identifikimin, shqyrtimin dhe vlerësimin e vendeve me rrezikshmëri të lartë në infrastrukturën rrugore, për rrugët që janë kompetencë e ministrisë, do ta bëjë ministria në bashkëpunim me institucionet relevante, ndërsa për rrugët nën përgjegjësinë e saj e bën komuna.

Neni 50

Kontrolli i sigurisë dhe mbajtja e evidencës për aksidentet e trafikut

1. Në rrugët TEN-T kryhen kontrollet e sigurisë për të caktuar karakteristikat e sigurisë së rrugëve dhe për të ulur numrin e aksidenteve të trafikut në to.
2. Kontrollet e sigurisë përfshijnë kontrollet periodike të rrugëve TEN-T dhe analizat e ndikimit të mundshëm të punimeve në rrugët në sigurinë e zhvillimit të trafikut, dhe kryhen në intervale kohore që sigurojnë nivelin e përshtatshëm të sigurisë.
3. Kontrollet kryhen sipas planit vjetor.
4. Për çdo aksident trafiku me të vdekur në rrugën TEN-T, përpilohet raporti sipas rregullit të përcaktuar në nenet 48,49 dhe 50 të këtij ligji.

5. Për zbatimin e neneve 45, 46, 47, 48, 49 dhe 50 të këtij ligji, ministria nxjerrë akte nënligjore.

Neni 51 **Mbikëqyrja dhe menaxhimi i kontratave**

1. Agjencia do të nxjerr rregullore të veçantë për procedurat, të drejtat, detyrimet dhe çështjet tjera të lidhura me ekzekutimin e kontratave për punë dhe shërbime.

2. Me këtë rregullore do të rregullohen: kushtet e përgjithshme, udhërrëfyesit për përgatitjen e kushteve të veçanta, formularët e dokumenteve të tenderit, marrëveshjet e kontratës dhe marrëveshjet mbi mospajtimet.

Neni 52 **Mbikëqyrja administrative**

1. Mbikëqyrja administrative në zbatimin e këtij ligji dhe akteve nënligjore për autoudhë, rrugë nacionale, rrugë rajonale dhe lidhëse, bëhet nga ministria.

2. Mbikëqyrjen administrative në zbatimin e këtij ligji dhe akteve i cili rregullon statusin e rrugëve të pakategorizuara dhe lokale e bën komuna.

Neni 53 **Punët inspektuese**

1. Punët e inspektimit të rrugëve publike nën përgjegjësinë e ministrisë, i kryen inspektori për rrugë i ministrisë.

2. Punët e inspektimit në rrugët publike lokale dhe të pakategorizuara i kryen inspektori komunal.

3. Inspektori në zbatim të paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, gjatë inspektimit të rrugëve publike përpilon raport me të gjeturat dhe rekomandimet për autoritetet sipas kompetencës si dhe personit fizik apo juridik.

4. Inspektori bën ndërprerjen e menjëhershme të punëve apo aktiviteteve në rrugën publike apo në elementet e infrastrukturës rrugore që nuk janë duke u realizuar në përputhshmëri me dispozitat e këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra mbi bazën e këtij ligji.

5. Policia e Kosovës gjatë patrullimeve rutinore si dhe me kërkesë apo informacion të ndryshëm nëse has në aktiviteteve në rrugën publike apo në elementet e infrastrukturës rrugore që nuk janë duke u realizuar në përputhshmëri me dispozitat e këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra mbi bazën e këtij ligji, bën ndërprerjen e punimeve deri në daljen në vendin e ngjarjes së inspektorit të ministrisë apo inspektorit të komunës.

6. Inspektori pas daljes në terren sipas paragrafit 5 të këtij neni, njofton Policinë e Kosovës për daljen në vendin e ngjarjes dhe veprimet e marrura.

Neni 54 **Përgjegjësitë e inspektorit**

1. Gjatë ushtrimit të aktiviteteve inspektuese të rrugëve publike, inspektori ka detyra dhe të drejta si në vazhdim:

1.1. inspektimin e rrugëve publike, brezit rrugor, brezit mbrojtës rrugor dhe strukturave në rrugë;

1.2. inspekton gjendjen e autoudhëve, rrugëve nacionale, rrugëve rajonale, pjesëve të këtyre rrugëve dhe strukturave rrugore;

1.3. inspekton punëkryesin gjatë ndërtimit, rindërtimit apo të mirëmbajtjes së rrugës publike, pjesëve të saj dhe strukturave rrugore si dhe kontratat tjera të infrastrukturës, se a është duke udhëhequr me rregull ditarin ndërtimor dhe librin ndërtimor si dhe masat për sigurimin e rrugës publike dhe qarkullimit rrugor;

1.4. ndërprerjen e punëve apo aktiviteteve në rrugën publike që nuk janë duke u realizuar në përputhshmëri me dispozitat e këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra mbi bazën e këtij ligji;

1.5. në rastet të rrezikimit të qarkullimit rrugor ose mund të shkaktohen dëmtime në të, inspektori duhet të urdhëroj masat e përkohshme, në mënyre që të mënjanoen rreziqet apo të pengohet dëmtimi;

1.6. të urdhëroj mënjanimin e pengesave që të sigurohet dukshmëria e nevojshme në rrugën publike;

1.7. inspektimin e realizimit të punëve në brezin rrugor;

1.8. asistimin e menaxherëve të kontratave sipas kërkesës së tyre në ekzekutimin e punëve dhe vendimeve për të cilat ai konsideron me rrezik potencial dhe nëse është e nevojshme siguron praninë e Policisë së Kosovës;

1.9. gjatë punëve inspektuese, inspektori po ashtu ka të drejtë:

1.10. të identifikoj personat juridik dhe fizik, të dhënat për pronësinë e automjeteve, mbi pronësinë e tokës dhe objekteve në brezin mbrojtës të rrugës, si dhe të dhëna tjera të nevojshme për zbatimin e procedurave në lidhje me shkeljen e këtij ligji dhe dispozitave për zbatimin e tij;

1.11. të inicioj procedurat për nxjerrjen e vendimit për rrënimin dhe largimin e objekteve të ndërtuara, përkatësisht të vendosur në brezin mbrojtës të rrugës publike;

1.12. të urdhëroj personin fizik apo juridik, rrënimin vullnetar të objektit të ndërtuar pa pëlqim në brezin mbrojtës dhe ajo pjesë të kthehet në gjendjen fillestare, në një afat që do ta përcaktoj inspektori, por jo më shumë se tridhjetë (30) ditë.

2. Nëse personi fizik apo juridik nuk vepron sipas urdhrit të inspektorit sipas nënparagrafit 1.12 të këtij neni, atëherë inspektori do të ndërmerr veprimet për rrënimin e objektit përmes kompanive përkatëse të kontraktuara për këtë qëllim nga ministria apo komuna dhe pjesa ku është ndërtuar pa pëlqim do të kthehet në gjendjen fillestare. Të gjitha shpenzimet do t'i bart personi fizik apo juridik i cili ka ndërtuar pa pëlqim:

2.1. të urdhëroj largimin e deponive të mbeturinave dhe të ngjashme që janë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji;

2.2. të urdhëroj rrënimin apo largimin e rrethojave, drunjëve, gardheve të mbjellë, materialit ndërtimor apo të ngjashëm si dhe tabelat me mbishkrime të vendosura në kundërshtim me këtë ligj;

2.3. të urdhëroj rrënimin apo largimin e objekteve, linjat e ujës-jellës, kanalizimit, linjat energjetike, të telekomunikacionit dhe instalimet e ndryshme të ndërtuara në brezin rrugor, apo në brezin mbrojtës në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji;

2.4. të largoj nga trafiku automjetin i cili është duke bërë transport të jashtëzakonshëm pa leje të posaçme;

2.5. të urdhëroj vendosjen e barrierave fizike për t'u pamundësuar kyçje apo qasje në rrugë publike, pa pëlqim nga Agjencia;

2.6. të urdhëroj largimin e automjeteve të parkuara apo të braktisura të cilat pengojnë shfrytëzimin dhe sigurinë rrugore;

2.7. përveç çështjeve të rregulluara me këtë ligj në fushën e inspektimit, ministria, përkatësisht komuna, me akt nënligjor rregullon organizimin, kompetencat, të drejtat, përgjegjësitë e inspektoratit dhe të inspektorit si dhe procedurat për zbatimin e këtij ligji;

2.8. inspektori i asistuar nga Policia e Kosovës për të realizuar kontrollin, ka të drejtë të ndalojë automjetet që qarkullojnë në rrugët publike përveç automjeteve të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Forcës së Sigurisë së Kosovës, KFOR-it dhe ndihmës së shpejtë. Gjatë ndalimit inspektori do të përdorë shenjën me mbishkrimin "STOP-inspektori".

Neni 55

Sanksioni kundërvajtës me gjobë

1. Me gjobë prej dymijë (2000) euro deri në dhjetëmijë (10000) euro dënohet për kundërvajtje personi juridik, nëse:

1.1. ndërton, krijon kyçje në rrugën publike pa pëlqimin e Agjencisë, neni 17, nënparagrafi 2.3 të këtij ligji;

1.2. shfrytëzon apo ndërton çfarëdo strukture ndërtimore në tokën rrugore dhe pjesët përbërëse të saj pa pëlqimin e Agjencisë, neni 17, nënparagrafi 2.4 të këtij ligji;

1.3. vendos pano të ndryshme reklamuese apo forma të tjera të informimit pa pëlqimin e Agjencisë, neni 17, nënparagrafi 2.12 të këtij ligji;

1.4. shfrytëzon kyçjen apo qasjen në rrugën publike pa pëlqimin e Agjencisë, neni 17, nënparagrafi 3.8 të këtij ligji;

1.5. ndërton çfarëdo objekti apo strukturë pavarësisht destinimit të saj, neni 17, nënparagrafi 3.9 të këtij ligji;

2. Për kundërvajtjet nga paragrafi 1 i këtij neni personi fizik që ushtron biznes individual, dënohet me gjobë prej pesëqind (500) euro deri në pesëmijë (5000) euro.

3. Për kundërvajtjet nga paragrafi 1 i këtij neni personi fizik, dënohet me gjobë prej dyqind (200) euro deri në dymijë (2000) euro.

4. Me gjobë prej njëmijë (1000) euro dënohet për kundërvajtje personi juridik, nëse:

4.1. dëmton, largon, zhvendos, fsheh, ose në ndonjë mënyrë tjetër ndërron gjendjen ekzistuese të sinjalizimit rrugor, pajisjeve rrugore dhe të ngjashme, neni 17, nënparagrafi 2.1 të këtij ligji;

4.2. uzurpon apo në një mënyrë tjetër e pengon shfrytëzimin e rrugës publike apo një pjese të saj, neni 17, nënparagrafi 2.2 të këtij ligji;

4.3. tërheq drunj dhe degë të drunjëve si dhe materiale dhe sende të ngjashme, neni 17, nënparagrafi 2.7 të këtij ligji ;

4.4. lejon ose lëshon kafshët shtëpiake pa përcjellës në rrugë, lidhjen e kafshëve shtëpiake në kanal in për largim të ujërave, apo kullotjen e kafshëve shtëpiake në tokën rrugore, neni 17, nënparagrafi 2.8 të këtij ligji;

4.5. vendos pllaka të varrezave, lapidarëve dhe përmendoreve të ndryshme, neni 17, nënparagrafi 2.11 të këtij ligji;

4.6. hedh borë apo akull në rrugë, neni 17, nënparagrafi 2.14 të këtij ligji;

4.7. bën punë tjera të cilat mund të dëmtojnë rrugën publike ose të rrezikojnë sigurinë rrugore, neni 17, nënparagrafi 2.16 të këtij ligji;

4.8. vendosja dhe përdorimi i dritave, apo pajisjeve ndriçuese të cilat mund të rrezikojnë sigurinë e trafikut në rrugën publike, neni 17, nënparagrafi 3.1 të këtij ligji;

4.9. ndezë qëllimshëm zjarrin dhe materiale që kundërmojnë në afërsi të rrugës publike, neni 17, nënparagrafi 3.2 të këtij ligji;

4.10. lëvtron tokën në distancë me të vogël se katër (4) metra nga skaji i tokës rrugore në drejtim të kundërt nga rruga publike ose në gjerësi një (1) metër nga skaji i tokës rrugore paralel me rrugën publike, neni 17, nënparagrafi 3.3 të këtij ligji;

4.11. vendosja e çfarëdo rrethoje, mbjellja e gardhit dhe drunjëve të tjerë të cilët pengojnë dukshmërinë e rrugës publike, neni 17, nënparagrafi 3.4 të këtij ligji;

4.12. lëshimi i kafshëve shtëpiake pa përcjellje, neni 17, nënparagrafi 3.5 të këtij ligji;

4.13. lënia e borës ose akullit që mund ta bëjë rrugën publike të rrëshqitshme, neni 17, nënparagrafi 3.6 të këtij ligji;

4.14. lënia e drunjëve dhe lëndët tjera dhe sendet që mund të bien në rrugë publike, neni 17, nënparagrafi 3.7 të këtij ligji.

5. Për kundërvajtjet nga paragrafi 4 i këtij neni personi fizik që ushtron biznes individual, dënohet me gjobë prej pesëqind (500) euro.

6. Për kundërvajtjet nga paragrafi 4 i këtij neni personi fizik, dënohet me gjobë prej treqind (300) euro.

7. Me gjobë prej një mijë (1000) euro dënohet për kundërvajtje personi përgjegjës i personit juridik, nëse:

7.1. pengon kullimin e ujërave nga rruga, neni 17, nënparagrafi 2.6 të këtij ligji;

7.2. vendos rrethoja, mbjellë gardh, drunj dekorativ dhe të ngjashme, neni 17, nënparagrafi 2.9 të këtij ligji;

7.3. vendos grumbuj të drunjëve, materiale të ndryshme dhe sende të tjera, neni 17, nënparagrafi 2.10 të këtij ligji;

7.4. hedh material të ndryshëm të betonit, vajit apo në çfarëdo mënyre e ndotë rrugën publike, neni 17, nënparagrafi 2.13 të këtij ligji;

7.5. operatori ekonomik i kontraktuar nuk mirëmban rrugët, nuk pastron, nuk pren barin i cili është me i lartë se njëzet (20) centimetra, nuk largon mbeturinat, sendet e hedhura në rrugë, pastrimin dhe riparimin e pahive elastike, nuk rivendos shenjat e larguara apo dëmtuara dhe ngjashëm, nuk ndërron poqët elektrike të cilat nuk janë funksional në përputhje me kushtet e kontratës.

Neni 56 **Aktet nënligjore**

Autoritetet kompetente për zbatimin e këtij ligji janë përgjegjëse të nxjerrin aktet nënligjore brenda një (1) viti pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 57 **E drejta e Ankesës**

1. Kundër secilit vendim të nxjerrë sipas këtij ligji lejohet ankesa në pajtim me rregullat e përcaktuara në Ligjin përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

2. Kundër vendimeve të lëshuara në procedurë të inspektimit sipas këtij ligji lejohet ankesa në pajtim me rregullat e përcaktuara në Ligjin përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

3. Organ eprorë që shqyrton ankesat sipas këtij neni është:

3.1. komisioni i ankesave i themeluar me vendim të Ministrit në Ministrinë përgjegjëse për transport për vendimet që merren nga kjo Ministri ose organet e saja.

3.2. komisioni i ankesave i themeluar me vendim të Ministrit në Ministrinë përgjegjëse për mjedis dhe planifikim hapësinor për vendimet që merren nga kjo Ministri ose organet e saja.

3.3. komisioni i ankesave i themeluar me vendim të Kryetarit të Komunës për vendimet që merren nga Komuna.

4. Organet e përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni me akte përkatëse nënligjore përcaktojnë përbërjen e komisionit dhe mandatin e anëtarëve të komisionit, të cilat nxjerrën tre (3) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Puna dhe procedura e komisionit të ankesave bazohet në rregullat e përcaktuara për organet kolegjiale në Ligjin përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Neni 58 **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohen Ligji Nr.2003/11 për Rrugët, Ligji nr.03/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Rrugë Nr.2003/11, Ligji Nr.06/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.2003/11 për Rrugë i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.03/L-120 dhe neni 74 i Ligjit Nr.08/L-176 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Neni 59 **Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare**

1. Në afat prej gjashtë (6) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, bëhet konstituimi dhe funksionalizimi i Agjencisë bazuar në këtë ligj.
2. Numri i vendeve të punës, stafi, pasuria e luajtshme dhe e paluajtshme do të transferohet nga Departamenti për Menaxhim të Rrugëve - DMRr në Agjenci.
3. Deri në funksionalizim të Agjencisë, funksionet e saja të përcaktuara me këtë ligj i ushtrjnë Departamentet përkatëse pranë Ministrisë.

Neni 60 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr.08/L-275
30 tetor 2024

Shpallur me dekretin Nr. DL-180/2024, datë 18.11.2024 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Vjosa Osmani-Sadriu